

LIGJ
Nr.10 020, datë 24.11.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË PËR HAPJEN E ZYRËS LOKALE GJERMANE PËR
BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për hapjen e zyrës lokale gjermane për bashkëpunimin për zhvillim në Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5971, datë 12.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË
PËR HAPJEN E NJË ZYRE LOKALE TË BASHKËPUNIMIT GJERMAN PËR ZHVILLIM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

në zbatim të marrëveshjes së datës 21 tetor 1988 ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik, si dhe duke iu referuar pikës 4 të shënimeve mbi protokollin e konsultimeve ndërqeveritare të datës 23 prill 2008 për përgatitjen e bisedimeve ndërqeveritare të

vitit 2008,
u morën vesh si vijon.

Neni 1

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, me qëllimin e mbështetjes së bashkëpunimit dypalësh ndërmjet dy vendeve, merren vesh për hapjen e një zyre lokale të bashkëpunimit dypalësh gjerman në Tiranë (më poshtë e quajtur “zyrë”). Kjo zyrë mund të shfrytëzohet nga të gjitha organizatat zbatuese gjermane, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në Republikën e Shqipërisë me porosi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe duke u marrë vesh me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Zyrës mund t’i jepen detyrat e mëposhtme:

1. Mbështetja për projektet në të gjitha aspektet e zbatimit të tyre.
2. Kryerja e detyrave më të gjera specifike dhe administrative në lidhje me zbatimin e projekteve, me të cilat merren organizatat e përmendura zbatuese me porosi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.
3. Kryerja e detyrave, të cilat nuk kanë të bëjnë me ndonjë projekt të përcaktuar, por me specifikat e vendit.
4. Përfaqësimi i organizatave zbatuese në vend.

Neni 3

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë jep kontributet e mëposhtme:

Ajo:

1. merr përsipër të gjitha shpenzimet për investimet në zyrë dhe për funksionimin e saj;
2. merr përsipër shpenzimet për specialistët e dërguar me qëndrim afatgjatë dhe afatshkurtër, si dhe për punonjësit vendas që punësohen nga zyra.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep kontributet e mëposhtme:

Ai:

1. i çliron livrimet e materialeve dhe të automjeteve për zyrën nga licencat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga tatimet e tjera publike, si dhe nga pagesat për magazinim dhe garanton që materialet të zhdoganohen pa vonesë. Çlirimet e përmendura vlejnë me kërkesë të zyrës edhe për materialet e siguruar në Republikën e Shqipërisë;
2. i mbështet kërkesat e zyrës për:
 - pajisje me lidhje telekomunikimi, duke përfshirë radiondërlidhje dhe lidhje me satelit;
 - lejet e punës dhe të qëndrimit të specialistëve të dërguar, si dhe për lejet e punës të punonjësve vendas të zyrës;
3. u garanton specialistëve të dërguar të organizatave zbatuese dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët bëjnë pjesë të ekonomisë familjare, të gjitha të drejtat në përputhje me marrëveshjen e lartpërmendur të datës 21 tetor 1988;
4. e çliron zyrën nga taksat dhe tatimet publike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Materialet e livruara për zyrën, duke përfshirë automjetet, mbeten pronë e organizatave zbatuese gjermane. Në çastin e shpërndarjes së zyrës, ato do të kalojnë në pronë të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Emërimi i organizatave zbatuese:

1. Qeveria e Republikës Federale jep kontributet e saj nëpërmjet organizatave zbatuese të përmendura në nenin 1.

2. Bashkëbiseduesi shqiptar për organizatat zbatuese është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Kjo marrëveshje vlen për një afat trevjeçar dhe do të zgjatet çdo herë për dy vjet, në qoftë se ajo nuk anulohet me shkrim nga një palë kontraktuese gjashtë muaj para mbarimit të afatit aktual të vlefshmërisë.

Neni 8

Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988.

Neni 9

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datë 23 tetor 2008 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.